

COVID-19: QASJE NDAJ MBROJTJES SË BIZNESIT

 *SI TË MENAXHONI BIZNESIN TUAJ PËRGJATË
KOHËS SË KRIZËS*

Prill - 2020



COVID-19: QASJE NDAJ MBROJTJES SË BIZNESIT

Të dashur partnerë biznesi,

Ndonëse kriza Covid-19 është pikë së pari një emergjencë e shëndetit publik, ndikimi ekonomik i virusit ka filluar të shfaqet dhe është e qartë tashmë që të gjitha bizneset do të preken, pavarësisht sektorit ku ata operojnë.

Për disa biznese, pandemia tashmë ka pasur një efekt të dëmshëm në fluksin e parave, që kërkon vëmendje të menjëhershme; të tjerët janë në një fazë ku është thelbësore të fillohet një planifikim serioz i emergjencave duke patur parasysh një rënie ekonomike në nivel global.

Në Mazars, ne po mbështesim bizneset të veprojnë tani për t'u mbrojtur nga efektet më të rënda të krizës. Ne kemi përvojën praktike dhe ekspertizën për t'i mbështetur bizneset gjatë rrugëtimit të tyre në kohëra të vështira.

Pavarësisht nëse është menaxhim i krizës së fluksit të parave apo planifikimi i rënies ekonomike, ne mund t'ju ndihmojmë në minimizimin e impaktit të tyre për biznesin tuaj.

Më poshtë ju përshkruajmë dy qasje të menjëhershme për të menaxhuar biznesin tuaj përgjatë kësaj krize. Ju lutem na kontaktoni për të diskutuar sesi mund t'ju ndihmojmë dhe t'ju mbështesim në mënyrë që të ngrihemi së bashku në këto kohëra të vështira për të gjithë ne.

Suporti ynë për këto shërbime do t'u ofrohet klientëve tanë pa pagesë.

Sinqerisht,



Diana YLLI
Partner
Mazars Albania
& Kosovo



Teit GJINI
Partner
Mazars Albania
& Kosovo

MBIJETESË E MENJËHERSHME E BIZNESIT

Identifikoni hapat e menjëhershëm për të mbyllur “hendekun e parave cash” duke përdorur gjashtë fushat e mëposhtme

1. Vlerësoni Efektin

- Përgatisni parashikimet e flukset monetare mbi baza javore përgjatë tre muajve të ardhshëm.

2. Përcaktoni “Hendekun e nevojave të parave cash”

- Vlerësoni të gjitha burimet e disponueshme të parave dhe linjat e kreditit/kuamarrjes, krahasuar me flukset hyrëse të parashikuara të parave.

3. Përgatisni planin për perballimin e “Hendekut të nevojave të parave cash”

- Përcaktoni masën në të cilin mbështetja e qeverisë do jetë në dispozicion për të ndihmuar biznesin tuaj.
- Përgatisni një program për zvogëlimin e kostove ose për shtyrjen e shpenzimeve dhe investimeve.
- Merrni në konsideratë mbylljen e përkohshme të operacioneve të caktuara.
- Krijoni burime financiare nga optimizimi i burimeve të brendshme dhe marrëdhëniet me partnerët kryesorë të biznesit.
- Përgatisni një pasqyrë të rishikuar të fluksit të parave bazuar në planin e veprimit të rimëkëmbjes.
- Përcaktoni sasinë shtesë të fondeve të jashtme që do të kërkohen.

4. Përgatisni një paketë informative për të komunikuar me palët e treta të angazhuara me programin e mbështetjes dhe financimit të krizës, e cila duhet të përmbajë:

- Historinë e mëparshme të biznesit dhe pasqyrat e fundit financiare/llogaritë mujore të manaxhimit.
- Përmbledhjen e planit të veprimit lidhur me rimëkëmbjen, për të mbyllur “hendekun e parave cash”.
- Pasqyrat e rishikuara të fluksit të parave bazuar në planin e veprimit të rimëkëmbjes.
- Shumat e përcaktuara që do kërkohen nga burimet e jashtme të financimit.
- Planin e financimit të krizës për të mbështetur biznesin për një periudhë afatmesme (d.m.th 12-18 muaj).

5. Angazhohuni dhe negocioni me palët e jashtme për të rënë dakord lidhur me marrëveshjet e duhura të financimit.

6. Përfshini grupet e duhura të interesit për të komunikuar elementët kryesorë të planit.

PËRGATITJA PËR ETAPËN E RËNIENS

Vlerësoni ndikimin e mundshëm të krizës në biznes në këto pesë fusha kryesore

1. Impakti i volumit të shitjeve

- Cili është ndikimi në volumin e shitjeve dhe kërkesës?
- Cilat janë implikimet në mbledhjen e parasë cash?

2. Stafi i vijës së parë

- Ekziston mundësia për individët kyç, të përballen me pamundësinë për të punuar, për një periudhë të zgjatur kohore?
- A ka vartësi kompania nga një fuqi punëtore, jo lehtësisht të zëvendësueshme?

3. Furnizuesit thelbësorë

- Ka vartësi kompania nga furnizues kyç, të cilët do të sillnin vonesa të konsiderueshme në dorezimin e mallrave, për shkak të ndërprerjes së mundshme të aktivitetit të tyre?
- Do të jetë e mundur për klientët kryesorë, ti furnizojmë me furnizim të mjaftueshëm?

4. Funkcionimi

- A ka kufizime në përdorimin e strukturave të biznesit dhe a mund të përshtatet modeli i biznesit tuaj në këto rrethana?
- A është e mundur të kryhen në distancë funksione të tilla të biznesit tuaj si hartimi i listëpagesave, financa, IT?

5. Detyrimet ligjore dhe rregullatore

- A ekziston rreziku i mos përmbushjes së marrëveshjeve kryesore kontraktuale dhe/ose kërkesave rregullatore?

SI MUNDET MAZARS TË NDIHMOJË KOMPANINË TUAJ NË KONTEKSTIN E SHPËRTHIMIT TË COVID-19?

Mazars në Shqipëri ka zhvilluar një grup pune për këshillimin financiar dhe tatimor të biznesit, i cili mund të ndihmojë subjektin tuaj në kontekstin e emergjencës së Covid-19. Pavarësisht nëse jeni një firmë shqiptare apo ndërkombëtare që operoni në Shqipëri, konsulentët tanë propozojnë zgjidhje të posaçme, për t'ju mbështetur në fushat e mëposhtme, duke kontribuar në qëndrueshmërinë, mbrojtjen dhe vazhdimësinë e biznesit tuaj:

1. KONSULENCË PËR VAZHDIMËSINË E BIZNESIT

- Këshillimi dhe mbështetja e kompanisë suaj, në lidhje me masat për vazhdimësinë e biznesit dhe përcaktimin e një strategjie mbrojtëse.

2. KONSULENCË TATIMORE

- Mbështetje me konsulencë tatimore.
- Monitorimi i mjedisit tatimor lokal dhe pasojat e tij për biznesin tuaj, në kontekstin e emergjencës të Covid-19.
- Përditësim në kohë lidhur me ndryshimet ligjore.

3. KONSULENCË NË MENAXHIMIN E FLUKSEVE TË PARASË

- Mbështetja e klientëve ndaj planifikimit strategjik afatshkurtër të biznesit.
- Analize për nevojat e parave cash, përgjatë periudhës së emergjencës së Covid-19.

4. KONSULENCË PËR MODELIMIN FINANCIAR DHE PLANIN E VEPRIMEVE

- Përgatitja e parashikimeve financiare afatshkurtra lidhur me Covid-19, për të mbështetur vendimet e investimeve /fondeve të menjëhershme.
- Përmirësimi i parashikimeve aktuale të biznesit, për të inkorporuar analizën e ndjeshmërisë financiare.
- Këshilla për format e mundshme të financimit, përfshirë grantet e financimit dhe skemat e siguruara nga Qeveria Shqiptare.

5. KONSULENCË PËR RISTRUKTURIMIN E KORPORATAVE

- Mbështetje në zhvillimin e planeve të qëndrueshme të rimëkëmbjes pas shpërthimit të Covid-19.

KONTAKT

Teit Gjini

Partner

teit.gjini@mazars.al

Diana Ylli

Partner

diana.ylli@mazars.al

www.mazars.al

Rreth Mazars

Mazars është një partneritet i integruar ndërkombëtarisht, i specializuar në auditim, taksë dhe shërbime këshilluese. Duke vepruar në 89 vende dhe territore në mbarë botën, ne mbështesim ekspertizën e 40,000 profesionistëve - 24,000 në partneritetin e integruar në Mazars dhe 16,000 përmes Aleancës Mazars të Amerikës së Veriut - për të ndihmuar klientët në çdo fazë të zhvillimit të tyre.